



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.10, datë 05. 04. 2012

**PËR
“EMËRTIMIN E SHKOLLËS “GJERGJ FISHTA””**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim Relacionin “Për emërtimin e shkollës “Gjergj Fishta”, në mbështetje të nenit 8/VII, gërma “b” dhe nenit 32, gërma “II” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 55/3 të ligjit nr. 7952, datë 21.07.1995 për “Sistemin arsimor parauniversitar” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë emërtimin e shkollës së re në Laprakë me emrin “Gjergj Fishta”.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI